

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 8003
E shtunë, 1 mars 2025
Çmimi 0.50

Tërnava uron besimtarët myslimanë për Muajin e Ramazanit | **FAQE 7**



Na ndiqni edhe në:


www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

NIS NUMËRIMI I FLETËVOTIMEVE NGA VOTIMI PËRMES POSTËS, KOALICIONET DUKEN TË PASHMANGSHME PËR FORMIMIN E QEVERISË



Në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve ka filluar të premtën numërimi i fletëvotimeve përmes postës. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se procesi i numërimit është

transparent dhe po zhvillohet në pranë të vëzhguesve të akredituar. Votat e diasporës, përfshirë ato nga votimi fizik në përfaqësi diplomatike si dhe nga votimi me postë, kanë shtuar

diskutimet nëse ato do të mund të përbëjnë ndryshim thelbësor në rezultatit zgjedhor, kështu që koalicionet duken të pashmangshme për formimin e qeverisë

27 VJET MË PARË LIKOSHANI DHE QIREZI U BËNË DËSHMITARË TË NJË PREJ AKTEVE MË TË TMERRSHME TË MAKINERISË SHTYPËSE SERBE F. 6



KURTI: PROKURORIA KA MOTIVE POLITIKE, JAM I GATSHËM TË DËSHMOJ NË ZYRËN TIME F. 3



AKTUALE



TRUMPI: PUTINI DO TA MBAJË FJALËN NËSE ARRIHET NJË MARRËVESHJE PËR T'I DHËNË FUND LUFTËS F. 2

ÇFARË KOMPETENCASH KA QEVERIA AKTUALE E KOSOVËS? F. 4

PROFESORI AMERIKAN: ASOCIACIONI DUHET TË FORMOHET F. 3

EKONOMI



ATK-ja, APEL QYTETARËVE: TË ARDHURAT E REALIZUARA NGA KRIPTOVALUTAT, JANË TË ARDHURA TË TATUESHME F. 8

RRITET KOSTOJA E NDËRTIMIT F. 8

KULTURË



Avni DEHARI

QYTET ME CERBERË NË PORTË F. 6

RENOVA
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501 289

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Trumpi: Putini do ta mbajë fjalën nëse arrihet një marrëveshje për t'i dhënë fund luftës

UASHINGTON, 28 SHKURT - Presidenti Donald Trump priti kryeministrin britanik Keir Starmer në Shtëpinë e Bardhë për të diskutuar mbi konfliktin Ukrainë dhe lidhjet tregtare dypalëshe, mes kërcënimeve për tarifa të udhëheqësit amerikan ndaj Evropës dhe kërkesave që kontinenti të mbështetet më pak tek Uashingtoni, lidhur me sigurinë e tij.

Përpara takimit, Trumpi tha se nuk do të flasë për detajet e një force paqeruajtëse pa u arritur një marrëveshje. "Shpresoj që ta kemi atë problem kur të shqetësohemi për ruajtjen e paqes. Ne duhet të arrijmë atje së pari", u tha Trumpi gazetarëve në Shtëpinë e Bardhë.

Edhe mes aleatëve evropianë ka dallime lidhur me dislokimin në të ardhmen të trupave në Ukrainë. Britania e Madhe mbështet një propozim të udhëhequr nga Franca, ndërsa vende të tjera, përfshirë Poloninë, e kanë përjashtuar atë. "Jam absolutisht i bindur se

kemi nevojë për një paqe të qëndrueshme, jo një armëpushim, dhe që kjo ndodhë, ne kemi nevojë për garanci sigurie", tha Starmer, duke shtuar se Britania do të bëjë pjesën e saj për të mbështetur këtë sipërmarrje, si pjesë e një marrëveshjeje paqeje për Ukrainën, por vetëm me mbështetjen e ShBA-së. Presidenti Donald Trump tha se ka besim se udhëheqësi rus Vladimir Putin do ta "mbajë fjalën" nëse arrihet një marrëveshje për t'i dhënë fund luftës në Ukrainë.

Presidenti amerikan tha se bisedimet me Rusinë dhe Ukrainën për një marrëveshje paqeje "kanë përparuar mirë" dhe vlerësoi Rusinë për qëndrimin e saj në bisedime. "Mendoj se Rusia ka vepruar shumë mirë... Mendoj se kemi përparuar shumë mirë në lidhje me marrëveshjen, por nuk kemi arritur ende një marrëveshje", tha Trump.

Kur u pyet nëse mund t'i besohej Putinit, Trump u përgjigj: "Beso e verifiko".



Kryeministri Starmer vizitoi Shtetet e Bashkuara, në përpjekje për të bindur presidentin Trump se një paqe e qëndrueshme në Ukrainë është e mundur vetëm nëse Kievi dhe udhëheqësit evropianë janë në tryezën e bisedimeve me Moskën.

Starmer u ka kërkuar Shteteve të Bashkuara që të ofrojnë një

garanci sigurie për çdo forcë evropiane që mund të marrë pjesë në një rol të mundshëm paqeruajtës në Ukrainë në përfundim të bisedimeve të paqes, për të cilat ka bërë thirrje Trumpit që kur mori detyrën muajin e kaluar.

Kryeministri britanik falënderoi presidentin Trump që i hapi rrugë "mundësisë për një

marrëveshje paqeje". Vizita e tij, që vjen disa ditë pas vizitës së presidentit francez Emmanuel Macron, pasqyron shqetësimin në rritje në Evropë se përpjekja e Trumpit për t'i dhënë fund luftës së Rusisë në Ukrainë sa më shpejt, sinjalizon gatishmërinë e tij për t'i bërë lëshime presidentit rus Vladimir Putin.

Kina zotohet se do të kundërpërgjigjet ndaj tarifave të fundit të ShBA-së

PEKIN, 28 SHKURT - Kina është zotuar se do të ndërmarrë "të gjitha kundërmarrjet e nevojshme" pasi presidenti amerikan, Donald Trump, tha se do të vendosë tarifë shtesë prej 10 për qind ndaj importeve kineze.

Vendimi i Trumpit do të hyjë në fuqi të martën e javës së ardhshme, së bashku me 25 për qind tarifa ndaj importeve kanadeze dhe meksikane, duke intensifikuar luftën tregtare mes dy ekonomive më të mëdha në botë.

Dhjetë për qind tarifa ndaj importeve kineze i shtohen taksës ekzistuese prej 25 për qind, vendim që Trump e mori më herët gjatë këtij muaji.

Trump kishte njoftuar - dhe më pas kishte pezulluar - tarifën prej 25 për qind ndaj importeve kanadeze dhe meksikane më herët gjatë këtij muaji. Por, pezullimi njëmuajor



merr fund të martën. Vendosja e tarifave, sipas Shteteve të Bashkuara, është bërë për shkak të emigrimit të paligjshëm dhe kontrabandimit të fentanilit.

Pas pyetjeve të gazetarëve nëse tarifaf do të hyjnë në fuqi javën e ardhshme, Trump shkroi në

rrjetet sociale të enjten se derisa të ndalojë problemi i fentanilit "apo të kufizohet", tarifafat e propozuara do të hyjnë në fuqi në datën e paraparë. "Po ashtu, në atë datë Kinës do t'i vendoset një tarifë shtesë prej 10 për qind", tha ai duke iu referuar 4 marsit.

Në përgjigje të akuzave të Trumpit se Pekini po kontribuon në krizën me fentanil në ShBA, një zëdhënës i Ministrisë së Tregtisë të Kinës tha më 28 shkurt se Uashingtoni "po e zhvendos fajin". "Kina është një nga vendet me politikafat më të rrepta kundër narkotikëve në botë. Por, pala amerikane gjithmonë i ka injoruar këto faktet", u tha në deklaratë. "Nëse pala amerikane insiston që të vazhdojë në këtë mënyrë, pala kineze do të ndërmarrë të gjitha kundërmarrjet e nevojshme për të mbrojtur të drejtat e saj legjitime dhe interesat e saj", tha zëdhënësi. Në këtë deklaratë po ashtu u tha se rritja e tarifave "nuk ndihmon në zgjidhjen e problemeve [të ShBA-së]", duke shtuar se rritja e tarifave do të rrisë "barrën ndaj kompanive amerikane dhe konsumatorëve

dhe do të minojë stabilitetin e zinxhirit industrial global".

Javën e ardhshme, udhëheqja e Kinës do të mblidhet për të prezantuar planet se si të mbrohet ekonomia kineze nga kërcënimet e Trumpit.

Presidentja e Meksikës, Claudia Sheinbaum, tha një ditë më parë se shpreson që të bisedojë me Trumpin në mënyrë që të shmangë tarifafat e paralajmëruara.

Ndërkaq, kryeministri kanadez, Justin Trudeau, deklaroi se zyrtarët po punojnë pa pushim që të shmangen tarifafat amerikane, por Kanadaja do të përgjigjet "menjëherë" nëse masafat hyjnë në fuqi javën e ardhshme.

Trudeau vazhdimisht ka theksuar se më pak se 1 për qind e fentanilit dhe e migrantëve të paligjshëm që hyjnë në ShBA, kalojnë përmes kufirit kanadez.

Greqia e paralizuar nga protestat

Athinë, 28 shkurt - Duke hedhur parulla për një drejtësi të pavarur, qindra mijëra grekë u janë përgjigjur thirrjes së sindikatave shtetërore dhe private për një grevë 24-orëshe dhe kanë dalë në një prej tubimeve më të mëdha të protestave të zhvilluara në tri dekadat e fundit në Greqi. Nga Athina, në Selanik dhe

në qindra qytete e komuna të vendit, si dhe në shumë kryeqytete evropiane, grekët protestojnë në përvjetorin e dytë të tragjedisë më të madhe hekurudhore të vendit, atë të përplasjes së trenave në luginën e Tempit ku humbën jetën 57 persona, mes tyre shumë studentë.

Dy vjet më vonë asnjë masë

sigurie në rrjetin hekurudhor të vendit nuk është përmirësuar, ndërsa edhe hetimi që ka nisur me vonesë nuk ka sjellë asnjë rezultat për t'i gjetur fajtorët e këtij aksidenti. Shumica e protestuesve vlerësojnë se drejtësia greke, e ndikuar nga qeveria në fuqi, është përpjekur t'i mbulojë shkaqet e aksidentit.



KOSTT dhe Lindja Solare L.L.C. nënshkruajnë marrëveshjen e kycjes për Parkun Solar Kramovik

PRISHTINË, 28 SHKURT - Kryeshefi ekzekutiv i KOSTT-it, Evetar Zeqiri dhe Luisa Helms, përfaqësuese e Lindja Solar L.L.C., kanë nënshkruar marrëveshjen e kycjes në Rrjetin e Transmetimit për ndërtimin e Parkut Solar Kramovik, një projekt me kapacitet të instaluar prej 105 MW që do ta fuqizojë prodhimin e energjisë së ripërtërishme në vend. Ky park do të ndërtohet në rajonin e Rahovecit, duke

kontribuar në rritjen e kapaciteteve të energjisë së pastër. Investimi është rezultat i një procesi konkurrues të organizuar nga Ministria e Ekonomisë, ku Lindja Solar L.L.C. u përzgjedh për zbatimin e projektit. Parku do të lidhet me rrjetin e transmetimit përmes një linje të re të dyfishtë 110 kV, me gjatësi 0.2 km, e cila do të integrohet në infrastrukturën ekzistuese

ndërmjet NS Klina dhe NS Gjakova 1. Ky projekt shënon një hap të rëndësishëm drejt diversifikimit të burimeve energjetike dhe forcimit të sigurisë energjetike të Kosovës. KOSTT-i ka theksuar se mbetet i përkushtuar për zhvillimin e një infrastrukture të avancuar dhe të qëndrueshme të transmetimit, duke mbështetur integrimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë në Kosovë.



KURTI: PROKURORIA KA MOTIVE POLITIKE, JAM I GATSHËM TË DËSHMOJ NË ZYRËN TIME

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

Prishtinë, 28 shkurt - Zyra e Kryeministrit i është drejtuar përmes një letre Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke kërkuar ta obligojë Prokurorinë Speciale që të marrë dëshminë e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, brenda zyrës së tij në Qeveri.

Më 19 shkurt Gjykata Themelore konfirmoi se Prokuroria Speciale i ka kërkuar asaj ta urdhërojë kryeministrin Kurti që të paraqitet në cilësinë e dëshmitarit në një rast të hapur lidhur me dyshimet për keqpërdorime me rezervat shtetërore, pasi Kurti kishte refuzuar dy ftesat e mëparshme.

Në letrën dërguar Gjykatës, Kryeministria përsëriti qëndrimin e shprehur më parë se Kurti nuk i ka refuzuar kërkesat për të dhënë dëshmi, por ai ka kërkuar që dëshminë ta japë në ambientet e qeverisë. "Kërkesa e tij që kjo të ndodhë në ambientet e Zyrës së Kryeministrit është plotësisht e arsyeshme dhe nuk mund të interpretohet si shmangie nga drejtësia. Në dritë të kësaj, me respekt kërkojmë nga gjykata që ta obligojë Prokurorinë Speciale ta marrë dëshminë e kërkuar brenda Zyrës së Kryeministrit", thuhet në letër.

Kryeministria pretendoi se ekzistojnë praktika kur zyrtarë të lartë janë intervistuar në ambientet e tyre të punës dhe kjo mund të përsëritet.

Në letrën drejtuar gjykatës, zyra e Kurtit hodhi dyshime edhe mbi natyrën e ftesës. "Ka



dyshime të forta që kjo thirrje nga Prokuroria nuk ka motiv ligjor, por politik. Prokuroria për vite me radhë ka dështuar në ndjekjen e rasteve të korrupsionit të profilit të lartë dhe në vend të adresimit të këtyre problemeve, po tenton të krijojë një perceptim të rrejshëm kundër Kryeministrit.

Një gjë e tillë është motivuar edhe nga qëndrimi publik i Kryeministrit kundër propozimit për emërim të z. Blerim Isufaj si kryeprokuror i shtetit. Rrjedhimisht, nuk mund të mos shohim çdo veprim të Prokurorisë Speciale si politikisht të motivuar, e publikisht të paarsyetuar", u

tha në letër, ku u kërkuar që gjykata të shqyrtojë çdo hollësi lidhur me këtë ftesë.

Në dhjetorin e vitit 2024 Prokuroria Speciale e Kosovës e kishte ftuar Kurtin të paraqitet në cilësinë e dëshmitarit në një rast të hapur lidhur me dyshimet për keqpërdorime të rezervave shtetërore. Kurti

kishte refuzuar të paraqitet në prokurori, duke u bërë thirrje prokurorëve të shkojnë ata dhe ta intervistojnë në zyrën e tij, në Kryeministri. Ftesën e parë Kurti e kishte marrë më 16 dhjetor, kur zëdhënësi i qeverisë, Përparim Kryeziu, kishte thënë se Kurti nuk ishte paraqitur pasi që ishte në udhëtim jashtë vendit dhe kishte shtuar se Kurti "ka shprehur gatishmërinë t'i mirëpresë prokurorët e rastit në zyrën e tij në një ditë dhe orë të dakorduar nga të dyja palët për ta përmbushur kërkesën e dalë nga ftesa e prokurorisë".

Katër ditë më vonë, Kurti kishte marrë sërish ftesë nga prokuroria, së cilës prapë nuk i ishte përgjigjur pozitivisht. Por, ftesa e Kurtit që të intervistohet në zyrën e tij është kritikuar nga ekspertë ligjorë.

Në vitin 2023 tre persona ishin arrestuar për rastin e rezervave shtetërore. Në mesin e tyre ishin edhe punonjës të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), që udhëhiqet nga Rozeta Hajdari, e cila, gjatë paraqitjes për dëshmi në Prokurorinë Speciale, ka zgjedhur të mbrohet në heshtje.

Në këtë ministri më 2023 u kryen bastisje pas publikimit të audioincizimeve nga portali "Nacionale", ku pretendohet se një sasi vaji, e blerë në Poloni, dhe një sasi gruri, e blerë në Turqi, nuk kishin arritur kurrë. Qeveria e Kosovës, e udhëhequr nga Albin Kurti, ka thënë se pagesat për rezervat shtetërore ishin bërë në përputhje me ligjin.


Profesori amerikan: Asociacioni duhet të formohet

PRISHTINË, 28 SHKURT - Profesori amerikan Alon Ben-Meir ka kërkuar që Kosova të jetë fleksibilie në veprimet e radhës që lidhen me dialogun dhe problemin e pazgjidhur me Serbinë, duke qenë se tashmë në krye të Shtëpisë së Bardhë është Donald Trumpi. Ben-Meir ka thënë se nëse Kosova s'do shkëmbime të territoreve, atëherë duhet ta

krijojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe dhe të bashkëpunojë me Serbinë. "ShBA-ja mund të vendosë sanksione, mund të mos e ndihmojë Kosovën ekonomikisht, mund t'i bëjë presion BE-së që të mos e avancojë Kosovën, mund të bëjë presion të konsiderueshëm nëse do, prandaj mendoj se s'mund ta

injoroni atë që do ShBA-ja. Asociacioni duhet të formohet. Nëse s'doni shkëmbime territoriale, bëjeni Asociacionin. Bashkëpunonim me Serbinë sepse Serbia ka interesa të mëdha në ato komuna meqë janë me shumicë serbe. Andaj duhet treguar fleksibilitet në këtë drejtim", ka thënë Meir për "Radio Evropa e Lirë".





NIS NUMËRIMI I FLETËVOTIMEVE NGA VOTIMI PËRMES POSTËS, KOALICIONET DUKEN TË PASHMANGSHME PËR FORMIMIN E QEVERISË

Në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve ka filluar të premtën numërimi i fletëvotimeve përmes postës. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se procesi i numërimit është transparent dhe po zhvillohet në prani të vëzhguesve të akredituar. Votat e diasporës, përfshirë ato nga votimi fizik në përfaqësi diplomatike si dhe nga votimi me postë, kanë shtuar diskutimet nëse ato do të mund të përbëjnë ndryshim thelbësor në rezultatin zgjedhor, kështu që koalicionet duken të pashmangshme për formimin e qeverisë

EPOKA E RE**Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 28 SHKURT - Në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve ka filluar të premtën numërimi i fletëvotimeve që i takojnë votimit jashtë Kosovës, respektivisht votimit përmes postës.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se procesi i numërimit është transparent dhe po zhvillohet në prani të vëzhguesve të akredituar. "Pas përfundimit të numërimit të ndonjë vendvotimi, brenda një kohe të shpejtë rezultatet për subjektet politike dhe kandidatët, të ndarë sipas komunave, të cilave u takojnë votuesit e regjistruar, do të

shfaqen në platformën rezultatet2025.net. Të gjithë shtetasit e Kosovës, që gjatë regjistrimit u përcaktuan individualisht për të votuar përmes postës, mund të dërgonin pakon e tyre me fletëvotim në adresë të ndonjërit nga kutitë postare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të hapura në shtete të ndryshme", ka njoftuar KQZ-ja.

Numri i pakove të supozuara me fletëvotime dhe që janë aprovuar nga KQZ-ja, pas procesit të vlerësimit, është më shumë se 63 mijë sosh. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vazhduar të publikojë të dhëna të reja lidhur me numërimin e votave nga

përfaqësitë diplomatike. Sipas përditësimit të fundit të bërë mëngjesin e 28 shkurtit, nga 93.02 për qind e votave të numëruara, Lëvizja Vetëvendosje prin me 80.75 për qind apo 10 898 vota. Në vendin e dytë është Partia Demokratike e Kosovës me 1 010 vota apo 7.48 për qind. Lidhja Demokratike e Kosovës ka fituar katër vota më pak se PDK-ja, përkatësisht 1 006 apo 7.45 për qind të votave. Ndërkaq, koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Nisma Socialdemokrate, Konservatorët e Intelektualët 1.93 për qind apo 260 vota. Për herë të parë Kosova organizoi votim fizik të pjesëtarëve të diasporës në përfaqësitë diplomatike të

vendit në botë. Votimet e 8 shkurtit u mbajtën në 43 vendvotime në 16 ambasada dhe 14 konsullata të Kosovës, në 19 shtete të ndryshme të botës. Përveç votave nga diaspora - qoftë në përfaqësitë diplomatike apo përmes postës - ende nuk janë numëruar edhe votat me kusht brenda Kosovës dhe votat e personave me nevoja të veçanta. Këto vota KQZ ka thënë më herët se do të numërohen në ditët në vijim, pasi paraprakisht është dashur të skanohen listat përfundimtare të votuesve të 9 shkurtit në mënyrë që të shmangen rastet e votimeve të dyfishta. Votat e diasporës përfshirë ato nga votimi fizik në përfaqësi diplomatike si dhe nga votimi me postë, kanë shtuar diskutimet nëse ato do të mund të përbëjnë ndryshim thelbësor në rezultatin zgjedhor. Naim Jakaj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi tha për RTV21 se votat e diasporës nuk përbëjnë ndonjë ndryshim të madh dhe se pa një koalicion mes partive politike nuk do të mund të formohet qeveria. "Në

fund të këtij procesi po duket që Vetëvendosjes do t'i shtohen një dy-tre deputetë, që në vetvete nuk përbën ndonjë ndryshim të madh apo t'ia mundësojë kësaj partie ta bëjë vetë qeverinë. Edhe tek PDK-ja e LDK-ja mund të ketë një numër më shumë e më pak, por në fund nuk do të ketë ndryshim që kishte për ta lehtësuar procesin, në kuptimin që një parti ta bëjë vetëm qeverinë. Pa ndonjë koalicion nuk do të bëhet një qeveri edhe nga ana e LV-së, po ashtu edhe nga radhët e partive opozitare. Do ta kenë të vështirë t'i kenë numrat", ka thënë Jakaj. Sipas rezultateve preliminare, që përfshijnë numërimin e votave të rregullta, Lëvizja Vetëvendosje është e para me 40.80 për qind të votave të fituara, pasuar nga Partia Demokratike e Kosovës me 22.05 për qind. E treta ka dalë Lidhja Demokratike e Kosovës me 17.64 për qind të votave, pasuar nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me 7.46 për qind të votave të fituara. Nga partitë e komunitetit serb, më së shumti vota ka marrë Lista Serbe, përkatësisht 4.62 për qind.

ÇFARË KOMPETENCASH KA QEVERIA AKTUALE E KOSOVËS?

Legjislacioni i Kosovës nuk e thotë shprehimisht se çfarë kompetencash ka qeveria e vendit në periudhën prej mbajtjes së zgjedhjeve deri në formimin e institucioneve të reja. Por, cilat, sipas interpretimeve të njohësve të ligjeve, janë përgjegjësitë dhe obligimet e qeverisë aktuale?

PRISHTINË, 28 SHKURT - Mes debateve për kompetencat e Qeverisë aktuale të Kosovës, edhe organizatat që monitorojnë punën e institucioneve shtetërore janë të ndara për këtë çështje.

Kosova aktualisht nuk ka as qeveri në detyrë, as qeveri në largim, por ekzekutiv me mandat të rregullt kushtetues, thonë nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), duke argumentuar se pushteti i tashëm ka kompetenca të plota deri në momentin kur certifikohet rezultati i zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit.

Ndryshe mendojnë në Grupin për Studime Ligjore dhe Politike (GLPS), ku qeveria e Albin Kurtit konsiderohet qeveri në largim, me detyra “të kufizuara në vazhdimin e punëve”.

Vullnet Bugačku, hulumtues i lartë në KDI, thotë për “Radion Evropa e Lirë” se ligjet, sikurse ai për qeverinë, Rregullorja e Kuvendit të Kosovës dhe Kushtetuta e vendit e lidhin mandatin e rregullt qeveritar me atë të legjislativit.

Ai pohon se qeveria aktuale ka mandat të rregullt, pasi nuk ka shpërndarje të Kuvendit, as shkarkim të kryeministrit apo dorëheqje të tij, që të plotësoheshin kushtet e parapara me ligj që ekzekutivit t’i kufizoheshin kompetencat aktuale. “Pra, mund t’i ushtrojë funksionet e saj dhe kompetencat e saj si një qeveri e zakonshme, sepse ende nuk ka skaduar mandati ligjor i kësaj

qeverie. Mandati ligjor i kësaj qeverie lidhet me situatën kur kemi përfundim të mandatit të legjislaturës së kaluar. Kjo është e ndërlidhur me certifikimin e rezultatit [zgjedhor]”, thotë Bugačku për “REL”-in.

Numërimi i votave të rregullta ka përfunduar tashmë, ndërsa para certifikimit të rezultateve ka mbetur edhe numërimi i votave me kusht, i votave të personave me nevoja të veçanta, si dhe i votave të diasporës.

Sipas rezultateve preliminare, Lëvizja Vetëvendosje (LV) ka fituar zgjedhjet me 40.80 për qind të votave të fituara, rezultat që i pamundëson ta krijojë vetë qeverinë. Udhëheqësi i LV-së, Kurti, thotë se qytetarët presin që partia e tij t’i krijojë institucionet e reja.

Përgjegjësitë e qeverisë

Ligji përcakton qartë kompetencat e qeverisë në përgjithësi, por edhe ato të kryeministrit, të ministrave e të zëvendësministrave. Këtu përfshihen marrja e vendimeve për çështje të caktuara, shkarkimi dhe emërimi i zyrtarëve, ndërmarrja e nismave legjislative, por edhe dërgimi i tyre në Kuvend, si dhe iniciimi i marrëveshjeve ndërkombëtare.

Bugačku nga KDI-ja thotë se, pavarësisht se me ligj qeveria ka kompetenca të plota, në këtë periudhë ajo duhet të ketë një lloj frenimi dhe të tregojë kujdes “që të mos marrë



veprime që do të prodhonin pasoja nesër për një qeveri tjetër”.

Ndryshe nga ai, Arbëresha Loxha-Stublla, drejtoreshë ekzekutive e GLPS-së, thotë për “REL”-in se qeveria nuk do të duhej të ndërmerre fare iniciativa të reja. Sipas saj, “qeveria tani vetëm zbaton”. Ekzekutivi aktual, thotë ajo, nuk duhet të paraqesë projektligje, as të bëjë emërimet e reja.

Por, Bugačku pohon se puna në këtë periudhë nuk i ndalohej as Kuvendit ndonëse, sipas praktikave, thotë ai, ky institucion e pezullon punën gjatë fushatës zgjedhore. Qeveria mbajti më 26 shkurt një mbledhje të rregullt dhe trajtoi 15 pika, ku u miratuan disa udhëzime, u emëruan persona në poste të caktuara dhe u ndanë fonde për disa aktivitete.

Për Bugačkun këto veprime janë të përditshme, që administrojnë gjendjen dhe nuk e prekin

shumë buxhetin, teksa thotë se ekzekutivi ka bërë një lloj kufizimi sa iu përket vendimeve që do të prodhonin pasoja për institucionet e reja. Nga GLSP-ja i kanë thënë më herët “REL”-it se qeveria aktualisht nuk mund të procedojë në Kuvend marrëveshje ndërkombëtare.

Kufizimi i kompetencave

Në legjislacionin e Kosovës përmenden dy lloje të qeverive, ajo me mandat të rregullt kushtetues dhe qeveri në dorëheqje. Por, termit si qeveri në largim apo në detyrë – që përdoren shpesh në periudhat paszgjedhore – nuk parashihen në ligjet e Kosovës, ndonëse janë pjesë e praktikës parlamentare të shteteve të ndryshme.

Por, si kalon qeveria me të drejta të plota në një ekzekutiv në largim, të cilit i kufizohen kompetencat?

As kjo nuk është e përcaktuar qartë në Ligjin për qeverinë, por kalimi në qeveri në largim bëhet me certifikimin e rezultatit të zgjedhjeve, thonë nga KDI-ja, për shkak të lidhjes që ka mandati i qeverisë me atë të Kuvendit.

Pas kësaj, Bugačku thotë se aplikohen kufizimet që parashihen në nenin 31 të ligjit, që kanë të bëjnë me qeverinë në dorëheqje.

Aty thuhet se qeveria s’ka të drejtë të miratojë nisma apo të nënshkruajë marrëveshje ndërkombëtare për të cilat kërkohet ratifikimi i Kuvendit, nuk mund të miratojë ligje, strategji e koncept-dokumente, as nuk mund të propozojë kandidatë për poste të caktuara, as të emërojë njerëz në pozita publike.

Qeveria aktuale është e para që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës që e ka çuar deri në fund mandatin kushtetues.

GJYKATA KUSHTETUESE ANËTARËSOHET NË KONFERENCËN EVROPIANE TË GJYKATAVE KUSHTETUESE

PRISHTINË, 28 SHKURT - Në takimin përgatitor të Qarkut të Presidentëve të Kongresit të 20 të Konferencës Evropiane të Gjykatave Kushtetuese (KEGJK), organizuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në Tiranë, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës është pranuar anëtare me të drejta të plota e këtij forumi prestigjioz të gjykatave kushtetuese dhe supreme evropiane.

Pranimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në KEGJK u parapri nga prezantimi i kërkesës për anëtarësim nga kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Nexhmi Rexhepi, i cili në fjalimin e tij

tha se “synimi ynë nuk ka qenë kurrë të ndjekim një avantazh politik duke iu bashkuar KEGJK-së por, përkundrazi, ta zëmë vendin e merituar në mesin e anëtarëve të një komuniteti që mbështet vlerat e demokracisë, sundimit të ligjit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në kontinentin evropian. Gjykata jonë është dëshmuar se është një gardiane e pasionuar e këtyre vlerave”.

Konferenca Evropiane e Gjykatave Kushtetuese (KEGJK) është themeluar në vitin 1972, me një anëtarësi prej 40 gjykatash kushtetuese dhe supreme të vendeve evropiane.



27 VJET MË PARË LIKOSHANI DHE QIREZI U BËNË DËSHMITARË TË NJË PREJ AKTEVE MË TË TMERRSHME TË MAKINERISË SHTYPËSE SERBE

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 SHKURT - Liderët shtetërorë dhe ata të partive politike kanë përkujtuar të premtën masakrën e Likoshanit dhe Qirezit, duke theksuar se për këto masakra ende nuk është ndarë drejtësi as nga prokuroria ndërkombëtare, as nga ajo e shtetit të Kosovës. "Më 28 shkurt 1998 regjimi gjenocidal i Millosheviqit kreu një nga aktet më të rënda të terrorit shtetëror, duke vrarë mizorisht 24 banorë të Likoshanit dhe Qirezit, në vatrën e rezistencës, në Drenicë. Aty ku dhimbja dhe guximi u ndërthurën, vajzat dhe djemtë e UÇK-së bënë sakrificën më të madhe për çlirim të Kosovës, ndaj në këtë 27-vjetor nderojmë me respekt të thellë ata që ranë për liri. Masakra në Likoshan dhe Qirez mbetet një dëshmi e brutalitetit të ushtruar mbi popullin tonë, por edhe një moment kur vendosmëria për liri u bë e pathyeshme. Kujtimi për martirët mbetet i gjallë, ndërsa amaneti i tyre na obligon ta vazhdojmë kërkimin e drejtësisë!", ka thënë presidentja Vjosa Osmani.

E kryeministri Albin Kurti ka theksuar se më 28 shkurt 1998 sulmi i forcave speciale të Serbisë, me artilleri të rëndë, vazhdoi për 28 orë në fshatrat Likoshan dhe Qirez. Kurti ka thënë se për këto masakra nuk kanë ndarë drejtësi as prokuroria ndërkombëtare pas çlirimit dhe as kjo e shtetit tonë pas shpalljes së pavarësisë. "Gjatë këtyre 27 viteve, shumë



dëshmitarë kanë ndërruar jetë, duke e bërë edhe më të vështirë zbardhjen e së vërtetës. Ende ka plot të mbijetuar dhe dëshmitarë të gjallë, që presin të dëshmojnë. Mosveprimi i institucioneve është padrejtësi e dyfishtë për viktimat dhe familjet e tyre, të cilat jetojnë me plagët e hapura dhe mungesën e përgjegjësisë. Përkulemi me respektin më të thellë ndaj të gjithë burrave e grave që ranë në rrugën tonë të gjatë për liri dhe Republikë. Lavdi dëshmorëve dhe martirëve të Likoshanit e Qirezit!", është shprehur Kurti.

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, së bashku me kolegë partiakë në Likoshan dhe Qirez u përkulën me respekt e mirënjohje para

martirëve dhe dëshmorëve të UÇK-së, të cilët 27 vjet më parë i dolën përballë armikut me guximin, besimin dhe gjakun e tyre. "Ata janë drita e pashuar e lirisë sonë dhe themeli i shtetit që gëzojmë sot. Ne nuk do t'i harrojmë kurrë!", ka thënë Krasniqi. Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se Likoshani dhe Qirezit u bënë dëshmitarë të një prej akteve më të tmerrshme të makinerisë shtypëse serbe. "Në fund të shkurtit 1998, të tronditura nga humbjet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, forcat serbe reagueshan me hakmarrje barbare, duke vrarë gra, pleq, fëmijë dhe të rinj të pafajshëm", ka thënë Haradinaj.

ORGANIZOHET PUNËTORIA 'PARANDALIMI I PËRDORIMIT TË LËNDËVE NARKOTIKE DHE SIGURIA NË SHKOLLA'

FERIZAJ, 28 SHKURT - Në vazhden e aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe parandaluese Policia e Kosovës/Drejtoria për Polici në Bashkësi dhe Parandalim, mbështetur nga misioni i OSBE në Kosovë, ka organizuar punëtorinë me temën "Parandalimi i përdorimit të lëndëve narkotike dhe siguria në shkolla.

Ky aktivitet është mbajtur në Ferizaj.

Seminari kishte për qëllim sensibilizimin dhe edukimin e nxënësve, mësuesve, prindërve dhe zyrtarëve policorë për pasojat e përdorimit të lëndëve narkotike dhe mënyrat efektive për ta parandaluar këtë fenomen në shkolla.

Ky aktivitet do ta ofrojë mundësinë për të diskutuar së bashku rolin e secilës palë në parandalimin e përdorimit të drogës dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet



institucioneve të arsimit, Qendrës për Punë Sociale dhe Policisë së Kosovës.


Diskutimet u përqendruan në rrezikun e abuzimit me drogat dhe ndikimin e tyre në shëndet dhe mësim. Politikat dhe masat e parandalimit të përdorimit të lëndëve narkotike. Përmirësimin e kapaciteteve për të identifikuar dhe

trajtuar rastet e reja. Këshilla praktike për mësuesit për të krijuar një mjedis shkollor të sigurt.

Në këtë punëtori morën pjesë 33 pjesëmarrës nga institucionet shkollore: profesorë, pedagogë, psikologë, nxënës, përfaqësues nga Qendra për Punë Sociale, policët hetues, policët e sektorëve (policët e lagjes) etj.

Avni DEHARI

QYTET ME CERBERË NË PORTË



(Natën mes 3 dhe 4 shkurtit të vitit 2000 formacioni kriminal serb "Rojat e Urës" në prani të KFOR-it francez dhe të policisë së UNMIK-ut në pjesën veriore të Mitrovicës sulmoi me armë banorët shqiptarë, nga të cilët dhjetë i vrau, me dhjetëra i plagosi e i torturoi dhe rreth 12 mijë i dëboi nga shtëpitë)

Një natë shkurti,
Të zezë si korbi,
Lukuni çmendurakësh,
Me trokëllima çizmesh,
Që tokën dridhnin,
Me rropama dyersh,
Të hapura krah më krah,
Copë-copë të shqepura,
Me bajoneta
Të lara në gjak,
Me armë,
Që zjarr villnin,
Lemeri përhapnin,
Vdekjen mbillnin,
Në qytetin përtej urës,
Që plagët e luftës po lëpinte!

Liria – Lule e Brishtë,
Në një qoshe sterrë
Ishte strukur;
Flokëhaparëshur,
Si në stuhi,
Kokën mbante me duar,
Të mos çmendej!
Buzën kafshonte,
– Plagë e hapur!
Pa një pikë gjak në fytyrë,
– Frika ia kishte prerë!
Pa veshë,
– Çirrat ia kishin pëlcitur!
Pa shpirt,
– Vveri ia kishte mbytur!
Pa zemër,
– Zog iu kishte bërë!
Puliste sytë
Të mos i shihte flakët,
Që shtëpitë përpinin,
Të mos i shihte shkelësit,
Që gjak për raki pinin!
Gjuha nyjë,
Një fjalë nuk ia nxirrte,
Për atë natë të kobshme,
Për atë natë Shën Bartolomeu!

Një natë shkurti,
Të zezë si korbi,
Në qytetin përtej urës
Njerëzit si hije,
Me kokë në gërrshërë,
Pa bërë një sy gjumë,
Pa i lidhur plagët e trupit,
Pa i kallur të vrarët në dhe,
Qytetit ia kthenin shpinën,
Ku sytë këmbët,
Vdekja ua puthte thembrat!

Qytet,
Me mina në urë,
Qytet,
Me cerberë në portë,
Qytet,
Me mure,
Pengesë në rrugë,
Bijtë e tu zemërthyer,
Me sytë nga ura,
Për çdo mëngjes
Ngjeshin bukën
E shpresës së kthimit!

Tërnavë uron besimtarët myslimanë për Muajin e Ramazanit

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

Prishtinë, 28 shkurt - Myftiu i Kosovës, Naim Tërnavë, i ka uruar besimtarët myslimanë për Muajin e Ramazanit, që nis të shtunën, më 1 mars.

Në mesazhin e tij tradicional për nisjen e këtij muaji, Tërnavë uroi që besimtarëve t'u pranohet agjërimi. "Vëllezër dhe motra, me rastin e fillimit të këtij muaji të bekuar, këshilloj vëllezërit dhe motrat e mi kudo që janë që të kenë frikë nga Zoti i Madhëruar, të garojnë në vepra të mira, të urdhërojnë njëri-tjetrin për të bërë mirë, të jenë të durueshëm, ta ruajnë unitetin e të mos përçahen, të bashkëpunojnë në mirësi, urtësi dhe devotshmëri, si dhe të ruhen nga të gjitha ato mëkate që Zoti i ka ndaluar. Kjo ngase Ramazani është një muaj madhështor, muaj në të cilin shumëfishohen veprat e mira dhe falen mëkatet për ata që agjërojnë dhe falin namazin

me besim dhe devotshmëri, duke kërkuar kështu shpërblimin për punët e tyre", ka thënë Tërnavë, duke shtuar se agjërimi ka shumë dobi dhe urtësi. "Duke e bërë agjërimin në formën më të mirë, besimtari e fisnikëron moralin, durimin, bujarinë dhe përpjekjet në atë që e kënaq Zotin. Muaji Ramazan është një mundësi që vjen vetëm një herë në vit, andaj ta shfrytëzojmë këtë mundësi dhe të përfitojmë prej tij, sikur të jetë Ramazani i fundit që do ta përfutojmë. Urime, shëndet dhe mbarësi për të gjithë besimtarët kudo që janë!", ka thënë Tërnavë.

Ai ka theksuar se besimtarët myslimanë me të drejtë e përfutojnë me përkushtim ardhjen e muajit të mirësisë, devotshmërisë, sakrificës dhe faljes së mëkateve. "Muaj i cili na sjellë mirësi, gëzim, bereqet, begati, mëshirë, lumturi, shëndet dhe paqe, si te fëmijët, te të rinjtë, te nipi e mbesa, te gjyshi e gjyshja, te babai dhe te



nëna, muaj i cili përshkon dhe ndriçon fytyrat dhe shpirtrat e të gjithë besimtarëve, andaj porositemi që ta shtojmë adhurimin dhe veprat e mira. Besimtarët e mirëpresin muajin Ramazan për ta rikthyer pastërtinë e zemrave, shkëlqimin e shpirtrave dhe kthjelltësinë e ndërgjegjes. Zoti i Plotfuqishëm na ka bekuar

me një muaj kaq të madh, pra ka ardhur koha e agjërit të këtij muaji, i cili sjellë vetëm ndërgjegjësim, devotshmëri dhe sakrificë, e këto burojnë nga thellësia dhe pastërtia e besimit në Zotin Një dhe të Vetëm", është shprehur Tërnavë.

Gjatë Muajit të Ramazanit besimtarët myslimanë

agjërojnë nga agimi deri në perëndim të diellit në shenjë sakrifice dhe përkushtimi ndaj Zotit.

Agjërimi është një nga pesë shtyllat e fesë islame. Muaji i Ramazanit këtë vit nis më 1 mars dhe përfundon më 29 mars. Ndërkaq, më 30 mars besimtarët myslimanë festojnë Fitër Bajramin.

Rektori Hajrullahu mban ligjëratë në Akademinë Diplomatike të Vjenës: Falë angazhimit dhe ndihmës së miqve, UP-ja po ia del

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 SHKURT - Në një ligjëratë dhe më pas bashkëbisedim në Akademinë Diplomatike të Vjenës, rektori Arben Hajrullahu foli për Universitetin e Prishtinës, të kaluarën, të tashmen dhe rrugën e tij përpara. Pasi dhjetë vjet të jetës dhe ngritjes akademike rektori Hajrullahu i kaloi pikërisht në Austri, Grac e Vjenë, ai e falënderoi që në hyrje të ligjëratës shtetin austriak për ndihmën e vazhdueshme që i ka dhënë dhe i jep arsimit në Kosovë.

Duke folur për sfidat kryesore të një universiteti në Ballkanin Perëndimor, me shembull UP-në dhe procesin e transformimit të tij në një institucion të shëkullit XXI, të kohës së inteligjencës artificiale dhe ndryshimeve të shpejta e të paparashikueshme teknologjike, rektori Hajrullahu



tha se koha në të cilën jetojmë ofron mundësi të mëdha, por edhe rreziqe.

Ai tregoi se si rriten sfidat dhe mundësitë e një universiteti të një vendi të vogël në kohën e dijës dhe konkurrencës globale.

Në këtë frymë, si pjesë e mundësive, u paraqit edhe diaspora akademike - kosovarët që janë formësuar në universitete me nam si në Evropë ashtu edhe në ShBA e përtej.

Rektori, duke folur për mundësitë, vuri theksin te rëndësia e transformimit digjital të universiteteve dhe te planet dhe punët që po realizohen në Universitetin e Prishtinës edhe në këtë aspekt.

Për më shumë, rektori Hajrullahu ritheksoi rëndësinë e vullnetit për ndryshime domethënëse si dhe avancimin e mendimit kritik në shërbim të interesit publik.

Rektori Hajrullahu foli edhe për të kaluarën e Universitetit të Prishtinës dhe ndihmën e madhe që ky institucion u ka dhënë proceseve që çuan në suksesin e përgjithshëm shoqëror dhe vetë shtetësinë e Kosovës, por shtoi se duhet të ketë shikime edhe më të madhe nga zhvillimet ditore politike, në mënyrë që UP-ja t'i kthehet edhe më fuqishëm shkencës dhe dijës.

Transparenca, llogaridhënia, ligjshmëria dhe meritokracia u paraqitën nga rektori Hajrullahu si parime udhëheqëse për një qeverisje të mirë dhe të suksesshme edhe të një institucioni të arsimit të lartë siç është Universiteti i Prishtinës.

Ndërron jetë fotoreporteri Alban Bujari

PRISHTINË, 28 SHKURT - Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës ka pranuar me pikëllim të thellë lajmin për ndarjen nga jeta të fotoreporterit të shquar Alban Bujari. "Bujari ishte një ndër emrat më të shquar të fotoreportazhit në Kosovë, i cili e dokumentoi luftën e viteve 1997-1999. Përkushtimi dhe guximi i tij në

dokumentimin që nga mediat vendore e deri tek ato më prestigjioze ndërkombëtare si Agjencia Evropiane e Shtypit (EPA), 'The Guardian', 'El País', 'The Independent', 'Zeitung' e të tjera, u bënë dëshmi për botën mbi realitetin e luftës dhe krizës humanitare në Kosovë", thuhet në telegramin ngushëllues të AGK-së.

Asociacioni i Gazetarëve të

Kosovës shpreh ngushëllimet më të sinqerta për familjen, miqtë dhe kolegët e tij. "Humbja e Alban Bujarit është një humbje e madhe jo vetëm për komunitetin e gazetarëve, por për të gjithë shoqërinë. Kujtimi dhe kontributi i tij do të mbeten të pashlyeshëm", theksohet në telegramin ngushëllues të AGK-së.



Oda e Përmbauesve, Murati: Tërhiq nga deklaratat e pabaza, ose do të të ndjekim me ligj

PRISHTINË, 28 SHKURT - Oda e Përmbauesve Privatë (OPP) ka dalë me reagim përmes të cilit ka hedhur kritika ndaj pretendimit të ministrit të Financave, Hekuran Murati, se përmbauesit po abuzojnë me tarifën. Bordi Ekzekutiv i OPP-së e ka konsideruar të pabazuar dhe të papranueshme deklaratën e ministrit

Murati, ku përmbauesit privatë akuzohen për "abuzim me tarifën". Kjo odë ka theksuar se përmbauesit privatë zbatojnë ligjin, e nuk e krijojnë atë. "Tarifat e përmbauesve nuk caktohen sipas dëshirës, por janë të përcaktuara qartë, bazuar në Ligjin për Procedurën Përmbaimore

dhe akte nënligjore, përkatësisht udhëzime administrativ konkret. Çdo tarifë është e rregulluar dhe transparente. Në vend që të drejtohen akuza të pabazuara ndaj përmbauesve, institucionet duhet të mbajnë përgjegjësi për vendimet që marrin dhe detyrimet që krijojnë", është thënë në reagimin e OPP-së.



ATK-ja, apel qytetarëve: Të ardhurat e realizuara nga kriptovalutat, janë të ardhura të tatueshme

PRISHTINË, 28 SHKURT - Administrata Tatimore e Kosovës ua ka rikujtuar të gjithë personave fizikë joafaristë, personave fizikë afaristë dhe personave juridikë, se janë të detyruar t'i deklarojnë dhe t'i paguajnë tatimet në mënyrë reale dhe në kohë, ashtu siç është përcaktuar me legjislacionin tatimor.

Në njoftimin për medie thuhet se aktivitetet e ATK-së në vazhdimësi do të përqendrohen pikërisht te personat të cilët nuk i deklarojnë të ardhurat e realizuara dhe nuk paguajnë tatimet.

Me fokus të veçantë, ATK-ja do të përqendrohet në identifikimin dhe trajtimin e personave të cilët realizojnë të ardhura nga kriptovalutat.

Detyrimet tatimore për të ardhurat e realizuara nga kriptovalutat varen nga ajo se çfarë statusi ka personi i cili ka realizuar të ardhurat, si: Nëse statusi i personit që ka realizuar të ardhurat e tilla është Person fizik jo afarist apo Person fizik afarist, duhet të

zbatojë dispozitat ligjore të përcaktuara me Ligjin Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale; Nëse statusi i personit që ka realizuar të ardhurat e tilla është Person juridik, duhet të zbatojë dispozitat ligjore të përcaktuara me Ligjin Nr. 06/L-105 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave.

Gjithashtu, theksohet se deklarimi dhe pagesa e tatimit për të ardhurat e realizuara nga kriptovalutat duhet të bëhet sipas normave dhe me formularët si në tabelën më poshtë. "Nëse personi krijon humbje, atëherë për humbjet e tilla mbanë evidencën të veçantë, të cilat duhet të jenë në dispozicion të ATK-së sa herë që kërkohen. Për personat fizikë jo afarist, personat fizikë afarist dhe personat juridikë, të cilët nuk deklarojnë të ardhurat e realizuara dhe nuk paguajnë Tatimet, ATK do të ndërmarrë masat sipas legjislacionit tatimor", thuhet në njoftim.

Administrata Tatimore e Kosovës u bënë thirrje të gjithë personave që t'i deklarojnë të



ardhurat e krijuara apo t'i korrigjojnë sa më parë deklaratat e tyre dhe t'i përmbushin të gjitha detyrimet tatimore të parapara me legjislacionin tatimor. "Me kryerjen e detyrimeve

tatimore, kontribuoni direkt në financimin e programeve qeveritare siç janë: ofrimi i shërbimeve publike, arsimim me standarde të larta, mirëqenie shëndetësore dhe sociale, mbrojtje ligjore dhe

siguri, si dhe infrastrukturë të përgjithshme për një mirëqenie më të mirë ekonomike dhe shoqërore. Pagesa e tatimit, siguron qëndrueshmëri të ekonomisë në vend".

Rritet kostoja e ndërtimit



PRISHTINË, 28 SHKURT - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Kostos së Ndërtimit (IKN) për tremujorin e Katërt (TM4) 2024.

Indeksi i tërësishëm i Kostos së Ndërtimit në Kosovë (IKN) pati rritje për 0.6 % në TM4 2024 krahasuar me TM3 2024. Ndërkaq, krahasuar TM4 2024 me të njëjtën periudhë të vitit paraprak TM4 2023, Indeksi i

Kostos së Ndërtimit pati rritje për 4.4 %.

Indeksi i tërësishëm i Kostos së Ndërtimit në Kosovë (IKN) pati rritje për (0.6 %) në tremujorin e katërt (TM4) 2024 krahasuar me tremujorin e tretë (TM3) 2024.

Rritje kishte transporti (2.4 %), pagat (0.9 %), materialet (0.5 %), kostot e tjera (0.4 %) dhe energjia (0.1 %). ndërsa zbritje kishte tek makineritë (-

0.2 %).

Indeksi i tërësishëm i Kostos së Ndërtimit në Kosovë (IKN) pati rritje (4.4 %) në tremujorin e katërt (TM4) 2024 krahasuar me tremujorin e katërt (TM4) 2023.

Rritje më të madhe kishte te energjia (20.6 %), pagat (12.8 %), transporti (10.9 %), materialet (2.7 %), makineritë (0.8 %), dhe kostot e tjera (0.7 %).

Arabia Saudite shpreh interesim për investime në Kosovë

PRISHTINË, 28 SHKURT - Një delegacion i Arabisë Saudite, i kryesuar nga Abdulhamit Jafer, ka ardhur për vizitë në Kosovë, me ç'rast ka vizituar Aleancën Kosovare të

Bizneseve (AKB). Në kuadër të kësaj vizite u tha se Arabia Saudite është e interesuar për t'i mbështetur iniciativat e investimeve private dhe publike në Kosovë sipas

kërkesave që ka Kosova. Kryetari i AKB-së, Agim Shahini, ka thënë se Kosova ka politikë më të mira për investim në Ballkanin Perëndimor dhe, sipas tij,

investitorët arabë kanë shprehur interesim. Të dyja palët u zotua që ta vazhdojnë komunikimin për të mirën e dy shteteve dhe bizneseve.



NËN THUNDRËN E UASHINGTONIT DHE MOSKËS

Marrëveshja e paqes e promovuar nga lideri amerikan nuk do të sjellë drejtësi për krimet e luftës të kryera nga Moska. Mendimet e një shkrimtari ukrainas



Vë bast se në këto kohë, kur zgjoheni në mëngjes dhe lexoni lajmet, nuk arrini t'u besoni syve. Si është e mundur që kjo po ndodh vërtet? Bota është zhytur vërtetë kaq thellë në marrëzi? Do dëshironit të zgjoheshit nga ky makth dhe të riktheheshit në rutinën e përditshme.

Dhe ja ku jemi, lufta është ende këtu, Rusia ka pushtuar tokën tonë. E megjithatë, makthi nuk ka përfunduar, sepse ky makth përforcohet edhe nga të tjerët. Realiteti i asaj që po ndodh është kaq absurd, sa që shpesh dëgjojmë të thuhet: "Nëse ky është një film, skenari është i keq."

Në këto vite, ne ukrainasit kemi kaluar të gjitha fazat e përbaljes me realitetin. E para ishte ajo e mohimit. Lufta nuk mund të ishte e vërtetë, sepse nuk ishte e drejtë. E vetmja gjë që na mbetej ishte të kapnim telefonat, të kontrollonim rrjetet sociale për të parë videot, për të dëgjuar intervistat dhe dëshmitë. Bota – besonim ne – do të zgjohej dhe do të zbulonte të vërtetën. Ishim të sigurt se brenda disa

javësh makthi do të merrte fund.

Më pas erdhi momenti kur realiteti na ra mbi kokë si një mur guri. Ushtria ukrainase po bënte përpjekje titanike për të mbrojtur vendin. Mes nesh, ata që kishin mundësi të largoheshin, ndiheshin fajtorë. Një vit më vonë, lufta ishte bërë tashmë pjesë e përditshmërisë sonë. Zemërimi ishte kthyer në një përrua të pandalshëm. Kur dikush përpqej të na qetësonte, ne i përgjigjeshim me një buzëqeshje ironike.

Kur lufta hyri në vitin e tretë, ne nuk kishim më energji për t'u zemëruar apo për të qeshur. Ashtu si urrejtja, frika është një emocion i lodhshëm. Nuk mund të jesh i frikësuar përgjithmonë. Dhe në momentin kur të pushton zbrazëtia, vjen dorëzimi i heshtur, pranimi fatalist i realitetit. Të gjitha energjitë duhet të kanalizohen në një mënyrë apo tjetër nëse do që të mbijetosh.

Në fillim të vitit të katërt të luftës, ne jemi të shkatërruar nga ëndrrat e paplotësuara dhe

nga një e ardhme krejtësisht e pasigurt.

Ideja e kthimit në kufijtë e vitit 1991 nuk është më e rëndësishme për ukrainasit. E vetmja gjë që ka rëndësi është fundi i luftës, por një fund që të parandalojë rikthimin e konfliktit pas disa viteve. Kjo është arsyeja pse fjala "fitore" është bërë pothuajse e pakuptimtë: është kthyer në një slogan retorik pa asnjë përmbajtje reale.

Sot flitet për mundësinë e një marrëveshjeje paqeje, por çdo marrëveshjeje për Ukrainën do të jetë një humbje. Disa skenarë janë më të këqij se të tjerët, por asnjëri nuk do të na japë atë që është e drejtë, nuk do të na japë drejtësi.

Një Titanik i fundosur

Në realitetin tonë të mbrapshtë, ne e dimë shumë mirë çfarë do të thotë "paqe". Për botën, ajo do të thotë fundi i luftës për dy vjet, pastaj nisja e një lufte të re. Për ne, do të thotë që një kriminel lufte mund të urdhërojë

ekzekutimin e mijëra robërve të luftës, të manipulojë imazhet e masakrave përmes propagandës ruse, të bombardojë spitale pediatrike dhe qendra kulturore, dhe pastaj të ulet në tryezën e negociatave sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Një botë ku askush nuk do të ndëshkohet për këto krime.

Përçmimi i botës ndaj drejtësisë është i qartë dhe ukrainasit e njohin shumë mirë këtë ndjenjë. Në fakt, asnjë "marrëveshje paqeje" nuk do të prodhojë rezultatin më të rëndësishëm: dënimin e kriminelëve të luftës dhe ndëshkimin e tyre për mizoritë e kryera.

Në vend që të ndalojë agresorin ose ta izolojë atë, bota do ta lërë të ulet rehat në tryezat e konferencave më prestigjioze, duke imponuar kushtet e tij. Bota nuk do të guxojë të bërtasë: nuk do ta ndalë atë.

Kjo është arsyeja pse ne ndjejmë se duhet të vazhdojmë të luftojmë. Vetëm armët mund ta zgjojnë botën dhe ta detyrojnë të dëgjojë.

Perëndimi na ka tradhtuar jo sepse nuk na ka ndihmuar, por sepse ka refuzuar të njohë të vërtetën, sepse kjo luftë është gjithashtu një krizë e Perëndimit.

Sot, udhëheqësit po përgatisin marrëveshje, duke u përpjekur të na bëjnë të pranojmë të papranueshmen, ndërsa ata që thonë se SHBA-të nuk do të luftojnë për të mbrojtur Evropën, që NATO-ja nuk do të bëjë asgjë, kanë të drejtë.

Tragjikisht, gjithçka ndryshoi jo kur u zbuluan krimet e Putinit në Ukrainë, por kur erdhi Donald Trump. Uashingtoni e detyroi Evropën të përfundojë me një marrëveshje që është një humbje për Ukrainën dhe një fitore për agresorin.

Dhe kjo është arsyeja pse ajo që po ndodh është e qartë: pandëshkueshmëria e Putinit për agresionin e tij në Ukrainë. Sot jetojmë në një botë që i përket diktatorëve, dhe që e quan Evropën një vend të ligë, ku ndodhen caqet e fundit të një bote demokratike. Por herën tjetër, viktima nuk do të jetë Ukraina. / bota.al



FFK-ja i jep Ballkanit fitore në tavolinë

Komisioni i Garave i ndeshjen ndaj Feronikelit kishte të drejtë loje dhe e dha fitoren 3-0 në rezultati i rregullt i kësaj Federatës së Futbollit të 74. Suharekasit u ankuan kanë fituar rastin. tavolinë kampionit në ndeshje kishte qenë i Kosovës e ka pranuar se futbollisti i Feronikelit Kësisoj, Federata e fuqi, që i afrohet Dritës barabartë, 1-1. ankesën e Ballkanit për 74, Lavdim Zumberi, nuk Futbollit e Kosovës ia në tetë pikë. Kujtojmë se

Sot dy ndeshje në Superligë, nesër dy të tjera

PRISHTINË, 28 SHKURT - Pro Credit Superliga po hyn në fazën vendimtare të kampionatit me rrethin e katërt, që premtion ndeshje shumë të forta dhe luftë deri në fund për çdo pozitë. Sigal Prishtina dhe Proton Cable Prizreni ndeshen në kryeqytet, me të dyja skuadrat që kanë pasur formë të ndryshme së fundi. Bardhekaltrit kanë shtatë fitore radhazi në elitë, duke mos pësuar humbje në vitin 2025 në Pro Credit Superligë, derisa prizrenasit janë në vështirësi, pasi ndodhen në pozitën e fundit me pesë fitore e 16 humbje, derisa prishtinasit janë në vendin e tretë me 13 fitore e tetë humbje. Takimi interesant shihet ai ndërmjet Pejës dhe Vëllaznimit, vendit të pestë dhe katërt në renditje. Verdhezinjtë kanë dhjetë fitore e 11 humbje, kurse kuqezinjtë 11 fitore e dhjetë humbje, andaj pritet një sfidë e baraspeshuar të shtunën mbrëma. Takimi kryesor i kësaj jave është



© kosovobasketballfederation

ndërmjet Trepçës dhe Bashkimit në "Minatori". Këto dy skuadra u përballën në finalen e Pro Credit Kupës më 12 shkurt, ku 'Xehetarët' fituan 85:79, për ta fituar Kupën për herë të katërt radhazi apo për herë të tetë në histori të klubit. Po ashtu, kjo sfidë është për vendin e parë.

Prizrenasit janë liderë me 15 fitore e gjashtë humbje, ndërsa mitrovicasit janë në vendin e dytë me 14 fitore e shtatë humbje. Në tri takimet mes këtyre dy skuadrave në këtë edicion të elitës, prizrenasit kanë dy fitore dhe një mitrovicasit, ku tri ndeshjet u fituan nga vendasit.

PROCREDIT SUPERLIGA - JAVA 22

TË SHTUNËN TAKOHEN:

19:00 Sigal Prishtina - Proton Cable Prizreni
19:00 Peja - Vëllaznimi

TË DIELËN TAKOHEN:

19:00 Trepça - Bashkimi
19:00 Golden Eagle Ylli - Bora

Sot përballen Suhareka - Gjilani dhe Feronikeli '74 - Dukagjini



GJILAN, 28 SHKURT - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) të premtion e ka publikuar orarin e ndeshjeve për javën e 22-të në Albi Mall Superligën e Kosovës. Kjo xhiro pritet të zhvillohet në tri ditë, duke filluar nga sot (e shtunë) me dy ndeshje, të dielën dy të tjera dhe të hënën ndeshja e fundit. Dy ndeshjet e para janë në mes të

Suharekës dhe Gjilanit dhe Feronikeli '74 e Dukagjinit, të cilat do të luhen nga ora 14:00. Nesër (e diel) do të luhen dy ndeshjet e tjera: Drita - Ferizaj dhe Malisheva - Ballkani. Derbi në mes të Prishtinës dhe Llapit është caktuar të zhvillohet të hënën, ku kësaj radhe do të luhet nën dritën e reflektorëve nga ora 20:00.

SHKURT

Statovci dënohet me dy ndeshje

Trajneri i KF Rilindja 1974, Faruk Statovci, është dënuar me dy ndeshje mosushtrim të detyrës zyrtare. Këtë vendim e mori Komisioni Disiplinor dhe Etikës i Federatës së Futbollit të Kosovës, pasi trajneri në fjalë ka bërë akuza dhe ofendime ndaj gjyqtarëve. "Kryetrajneri i KF Rilindja 1974, Faruk Statovci, pas përfundimit të pjesës së parë duke shkuar në zveshtore filloi me fyerje, akuza dhe ofendime në drejtim të gjyqtarëve deri në zveshtore, mirëpo nuk mbaroi me kaq sepse pas përfundimit të ndeshjes, Statovci përsëri vazhdoi me fyerje, akuza dhe ofendime ndaj gjyqtarëve, mirëpo falë intervenimit të policisë u evitua më e keqja. Sipas raportit të personave zyrtarë në ndeshjen Rilindja 1974 - Istogu. Bazuar në nenin 15, paragrafi 1, pika C i Rregullores disiplinore; dënohet me 2 (dy) ndeshje mosushtrim të detyrës zyrtare sipas radhës organizuar nga FFK", thuhet në njoftimin e FFK-së.

Kosova siguron tri medalje në turneun e boksit në Bullgari

Përfaqësuesit e Kosovës në boks në Turneun Ndërkombëtar "Strandja" që po mbahet në Sofje të Bullgarisë kanë siguruar tashmë tri medalje. Pas boksieres Donjeta Sadiku, e cila ka kaluar në gjysmëfinale të garës, medalje kanë siguruar tashmë edhe dy boksierë. Të enjten në çerekfinale të garës ishin dy boksierë nga Kosova, ku i pari në orar ishte Bashkim Bajoku, i cili kishte për kundërshtar boksierin Sabyrkhan Makhmud nga Kazakistani, i cili nuk mundi ta largojë peshën dhe Bajoku fitoi duelin pa luftë dhe siguroi medaljen e bronzë duke u kualifikuar për gjysmëfinale. Po ashtu, në luftë për medalje në kategorinë deri në 71 kg, Loris Idrizi për kundërshtar kishte boksierin bullgar, Mitev Kristiyan, të cilin e mundi me plot meritë dhe siguroi medaljen e tretë të bronzë për Kosovën. Ndryshe, këto janë medaljet e para të Kosovës pas më shumë se 40 vjetëve nga turneu ndërkombëtar "Strandja".

Shkëlqeu ndaj kampionëve, Lomax shpallet MVP

Bora arriti fitoren më të madhe në këtë edicion, duke mundur kampionët e Kosovës, Trepçën, 89:88, në edicionin e parë në garat e elitës. Ndaj kampionëve shkëlqeu Alex Lomax me 25

pikë, shtatë kërcime dhe 12 asistime. Ai kishte indeksin 39 apo më të lartin e javës së 21-të, duke u shpallur MVP. Ndeshje fantastike kishte edhe Arian Qallaku i Golden Eagle Yllit përballë Proton

Cable Prizrenit. Basketbollisti i Kosovës e mbylli ndeshjen me 22 pikë, tetë kërcime dhe pesë asistime. Në fitoren ndaj prizrenasve ndeshje shumë të mirë zhvilloi edhe Jan Palokaj me 23 pikë, dhjetë

kërcime dhe katër asistime. Bashkimi me përmbysje fitoi ndaj Pejës, ku më i miri te prizrenasit ishte Mack Smith me 19 pikë, katër kërcime dhe dy asistime. Ndeshja e vetme që ishte zhvilluar më

parë në mes të Sigal Prishtinës dhe Vëllaznimit u kishte takuar kryeqytetasve ku, si zakonisht, u dallua Rashid Mahalbasiq me 16 pikë, dhjetë kërcime dhe një asistim.

Triumfojnë lakersat dhe Warriorsi

LOS ANXHELOS, 28 SHKURT - Fitorja e katërt radhazi për lakersat, që në fushën e tyre mundën me rezultat 111-102 Minnesotan, në një ndeshje me rivalitet. Le Bron Jamesi me 33 pikë e 17 rebounde, Reaves me 23 pikë e Donqiqi

me 21 pikë bënë dallimin në fushë për kalifornianët. Jashtë fushës triumfoi edhe Golden State, që mundi me rezultat 121-115 Orlandon. Mbrëmje magjike për Stephen Curry, autor i 56 pikëve, me 12 guajtje të sakta nga

distanca. Ekipi i Dallasit, falë 25 pikëve të Kyrie Irvingut, mundi 103-96 Charlotten. Milwaukee fitoi 121-112 ndeshjen ndaj Denverit, dy ekipe pretendente për titull. Antetokounmpo me 28 pikë e 19 rebounde ishte lider për

Bucksin, duke i bërë të pavlefshme 32 pikët e Jokiqit. Rezultatet: Orlando - Golden State (115-121), Milwaukee - Denver (121-112), Dallas - Charlotte (103-96), Phoenix - New Orleans (116-124), Lakers - Minnesota (111-102).



Kosova U18 e luan ndaj Nigerisë ndeshjen e parë në IHF Trophy Intercontinental

PRISHTINË, 28 SHKURT - Tashmë është përcaktuar edhe orari i ndeshjeve për fazën ndërkontinentale të kampionatit IHF Trophy. Kampionati organizohet për grupmoshën U18 dhe U20, ndërsa kombëtares fituese kualifikohen në Kampionat Botëror. Në grupmoshën U18 të IHF Trophy Intercontinental paraqitet edhe Kombëtarja e Kosovës që, megjithatë, është e lirë në ditën e parë, më 12 mars. Më 12 mars janë ndeshjet Uzbekistani - Nikaragua (15:00) dhe Kaledonia e Re - Nigeria (17:00). Para ndeshjes së dytë është hapja zyrtare.

Në ditën e dytë, më 13 mars, janë ndeshjet ShBA-ja - Nikaragua dhe Nigeria - Kosova. Ndeshja e Kosovës fillon në orën 17:00. Më 14 mars janë takimet ShBA-ja - Uzbekistani dhe Kosova - Kaledonia e Re. Më 15 mars janë gjysmëfinalët, ndërsa më



16 mars janë ndeshja për vend të tretë dhe finalja. Kosova U18 është në Grupin B së bashku me Nigerinë dhe Kaledoninë e Re. Në Grupin A janë ShBA-ja, Nikaragua dhe Uzbekistani. Sa i takon garës në grupmoshën U20, Grupi A përbëhet nga

ShBA-ja, Bullgaria dhe Kaledonia e Re. Kurse në Grupin B garojnë Ruanda, Nikaragua dhe Uzbekistani. Më 12 mars janë ndeshjet Kaledonia e Re - Bullgaria (11:00) dhe Uzbekistani - Nikaragua (13:00).

Messi për kohën te PSG-ja: Asnjë ditë nuk isha i lumtur

PARIS, 28 SHKURT - Lionel Messi ka thënë se nuk ka qenë asnjëherë i kënaqur përgjatë dy vjetëve të kaluara te Paris Saint-Germaini. Messi i ishte bashkuar PSG-së nga Barcelona, dhe në fazën e sulmit kishte bashkëlojtar si Kylian Mbappe e Neymar. Fituesi i Kupës së Botës ka folur në një intervistë dhënë për "AppleMusic", shkruan "Sky Sport" të premtën. Problemet financiare të Barcelonës bënë që Messi në vitin 2021 t'i bashkohej skuadrës parisienne. Me PSG-në, Messi i fitoi dy tituj të kampionatit elitare të Francës. "Gjithmonë e kisha në mendje të luaja në ligën MLS. Më ka tërhequr dhe ishte diçka që doja ta bëja. Ato dy vjet nuk



ishin të mira për mua. Nuk isha i kënaqur në asnjë ditë, me stërvitjet, ndeshjet. E kisha të vështirë të adaptohesha. E mendova t'i bashkohesha Inter Miami sepse klubi po

rritet vazhdimisht. Më pëlqeu ideja që të vija e ta ndihmoja klubin të bëhej i madh. E dija, po ashtu, se qyteti do t'i pëlqente edhe familjes sime", ka deklaruar Messi.

SHKURT

Kampioni i botës në fuqi në MotoGP mungon në dy garat e para

Më 2 mars do të nisë Botërori 2025 në MotoGP, event i rëndësishëm i motoçiklizmit në botë. Gara e parë do të zhvillohet në pistën e Buriram, në Tajlandë. Në këtë garë do të mungojë piloti spanjoll i Aprilia, Jorge Martin, i aksidentuar dhe më pas operuar rreth dy javë më parë, gjatë testeve zyrtare. Madje ai nuk do të jetë as në garën e dytë në Argentinë më 16 mars. Motori italian Ducatishihget si favorit edhe këtë vit, me italianin Francesco Bagnaia që do të ketë një duel "kokë më kokë" me shokun e tij të skuadrës, spanjollin Marc Marquez, por priten edhe surpriza. Gjithsej do të jenë 22 gara në këtë sezon, që do të mbyllet më 16 nëntor. Pritet një rivalitet i fortë mes pilotëve, një sezon ku gabimet mund të kushtojnë shumë.

Zdenek Zeman në terapi intensive, por po reagon ndaj trajtimit

Zdenek Zeman ndodhet ende i shtruar në terapi intensive në Policlinico Gemelli të Romës, por trajtimi i parë ka dhënë rezultate pozitive. Trajneri çek, i cili po trajtohet në repartin e specializuar për goditje në tru (Stroke Unit) për shkak të simptomave të një patologjie ishemike, po tregon shenja përmirësimi dhe po reagon ndaj terapi intensive mjekësore. Pas frikës së madhe, burime nga spitali i kryeqytetit italian bëjnë me dije se ish-trajneri i Romës dhe Lazios është i vetëdijshëm dhe bashkëpunues. Ai është nën mbikëqyrje të vazhdueshme me kontrolle kardiologjike dhe neuro-radiologjike për të shmangur çdo përkeqësim të mundshëm por, fatmirësisht, nuk është në rrezik për jetën. Për Zemannin, i cili drejtoi për herë të fundit Pescaran më 13 shkurt 2024 (në humbjen kundër Spal, përpara një tjetër problemi shëndetësor), janë planifikuar kontrolle të mëtejshme në orët në vijim. Ndërkohë, ai do ta vazhdojë trajtimin me ilaçe antiagregante dhe antikoagulate.

Neymari: Reali më ofroi një çek të pastër, por unë doja Barcelonën

Neymar Junior është hapur për lëvizjen e tij te Barcelona nga Santos në vitin 2013 dhe ka zbuluar se sa shumë dëshironte Real Madridi të nënshkruante me të. Pavarësisht se Real Madridi i ofroi atij atë që Neymar pretendon se ishte një "çek bosh", ai donte të bashkohej me Barcelonën. "Oferta e Real Madridit ishte një çek bosh, ata më thanë se mund të kem çfarë të dua... por unë e doja Barçën me zemër", ka thënë fillimisht Neymari për "Podpah". Tutje, ylli brazilian ka treguar dallimin mes asaj që fitoi te Barcelona dhe do të fitonte te "Los Blancos" nëse do të nënshkruante. "Do të kisha fituar tri herë më shumë para në Real Madrid. Florentino më ka pëlqyer gjithmonë. Por, Ronaldinho luajti atje dhe unë doja të luaja me Messin", ka deklaruar Neymari.

Schumacheri ulet në një Mercedes për ta stimuluar trurin me zhurma të njohura

Dhjetë vjet pas aksidentit në Meribel, një zbulim i gazetës gjermane "Bild" duket se hap një dritare të vogël se si familja dhe mjekët po përpiqen ta ndihmojnë Michael Schumacherin, shtatë herë kampionin e botës në Formula

1. Kampioni gjerman, që ka pilotuar edhe Benetton e Ferrari, është marrë me një Mercedes AMG, divizion i kompanisë me bazë në Shtutgart që prodhon automjete me performancën

më të lartë, për ta stimuluar trurin e tij me zhurmata e njohura. Nuk ka asnjë informacion të mëtejshëm nëse ky eksperiment ka dhënë rezultat apo jo. Michael Schumacher ishte viktimë e një aksidenti

në ski dhjetë vjet më parë, që ndryshoi jetën e tij dhe të familjes së tij përgjithmonë. Në ditët në vijim do të transmetohet edhe në Gjermani një dokumentar me pesë pjesë që transmetuesi ARD i ka kushtuar jetës së ish-

pilotit. Në vitin 2021 një tjetër dokumentar u transmetua në "Netflix", i autorizuar nga gruaja e tij Corinna, në të cilin ajo dhe fëmijët e saj folën zyrtarisht për herë të parë për gjendjen shëndetësore të Schumacherit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "ING-VE&DISI" SH.P.K. me seli në Gjakovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 70841096 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "ING-VE&DISI" D.O.O. Djakovica donelo odluku o prestani rada sa nrb. 70841096 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "ING-VE&DISI" L.L.C. with headquarters Djakovica, has come to the decision to quit its business: 70841096 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejite

RESTAURANT**SWISS
TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898
 Sallon Depilimi Lume's Details
 lumesdetails
 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ardiana Sahiti shpall të pavlefshme certifikatën e numrit fiskal: 601090525.

-Arben Smani B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811012418.

- Shkurtesa Gashi shpall të pavlefshme Diplomën e shkollës së mesme Ekonomike "Ymer Prizreni", Prizren.

- Albert Dvorani shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike "Fehmi Lladrovci" Drenas.

- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.

- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m."Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit "Hajdar Duishi" Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





TRADITË QË NGA

1992

